



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 31.03.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.03.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "SIB-BKA SHPK" për aktivitetin: "Hartimi i projekteve për ndertim të lartë" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-8590-221** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik "SIB-BKA SHPK" e datës 29.03.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projekteve për ndertim të lartë" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-8590-221** kundër *Njoftimit për dhenje të Kontrates të AK-se të datës 24.03.2021*, të publikuar në Platformën E Prokurimi.

1. Vërtetohet *Njoftimi për dhenje të kontrates i Autoritetit Kontraktues të datës 23.03.2021 dhe AK-ja vazhdon aktivitetin sipas të njejtit;*
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "SIB-KA SHPK" me datë 29.03.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i projekteve për ndertim të lartë" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-8590-221**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 31.03.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi i pare është i pa bazuar sepse AK-ja nuk ka kërkuar asnjë shenim specifik, por vetëm dëshminë e regjistrimit të biznesit dhe në të njëjtën nuk shenon se ajo leshohet për afat të caktuar, por vetëm shenohet data e fillimit e jo data deri kur mund të zhvillohet aktiviteti i kompanisë dhe është dhënë data e emerimit të administratorit dhe data e përfundimit të mandatit. Pra për AK-në kjo është e pranueshme, sepse vlerësimi i asnjë tenderi nuk mund të bëhet në bazë të kërkesave që nuk janë në FDT;

-Pretendimi lidhur me sigurimin e tenderit poashtu është i pa bazuar, pasi që mund të plotësohet nga cili do anëtar i grupit dhe nuk ka asnjë rregullë që e kushtëzon plotësimin e kësaj kërkesë;

-Pretendimim per datat e referencave ka te beje me ndonje gabim teknik,por referencat tjera e plotesojne kerkesen e AK-se,ndersa shumica e e referencave jane dhene ne forme te verrtetimit te realizimit te projekteve,e qe per AK-ne jane te pranueshme;

-Poashtu pretendimi se nuk jane vleresuar drejt paisjet e tenderuesit te rekomanduar per kontrate eshte i pa bazuar,pasi qe i njeiti ka deshmi valide per posedim,garancion dhe kalibrim per dy paisje GPS :South Galaxy 61 plus dhe Trimbe Ry me total station Leica 703,pako GPS Hi target V 30 dhe HTS 420 R me Çertifikata valide te kontrollit.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

